

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT-UDHËZIMIT “PËR KUSHTET TEKNIKE TË IMPORTIT-TREGTIMIT, MIRËMBAJTES , TESTIMIT DHE SHËRBIMIT TË APARATEVE PËR FIKJEN E ZJARRIT

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projekt-udhezimi që propozohet të miratohet synon të garantojë zbatimin e politikave të veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” në pikën 2 të nenit 8, të pikës 1,2,3,4 të nenit 44 të tij.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekt-udhezimi “Për kushtet teknike të importit-tregtimit, mirëmbajtjes, testimit të aparateve të fikjes së zjarrit”, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Projekt-udhezimi “Për kushtet teknike të importit-tregtimit , mirëmbajtjes, testimit të aparateve të fikjes së zjarrit” disiplinon procedurat e klasifikimit dhe miratimit të standarteve për pajisjet e fikseve të zjarrit dhe ka për qëllim parandalimin e zjarrit të cilat i referohen standarteve/normave të miratuara sipas direktivave EN-3, EC lidhur me fikset e zjarrit.

Projekti përcakton kërkesat teknike të aparateve të fikseve të zjarrit që importohen dhe hidhen në treg për herë të parë, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat sipas standarteve/normave të miratuara nga vendet e Bashkimit Evropian më qëllim garantimin dhe efikasitetin e duhur të fikseve të zjarrit.

Referuar misionit të Drejtorisë së Përgjithshme, në kuadër të funksionit publik, kjo drejtori ka si qëllim të vendosë rregulla, standarte për subjektet juridike dhe subjektet fizike të cilët merren me importin, tregtimin dhe mirëmbajtjen e fikseve të zjarrit si dhe sistemet stacionare të fikjes së zjarreve si dhe ndaj subjekteve fizikë ose juridikë të cilët duhet të posedojnë dhe shfrytëzojnë këto pajisje.

Gjithashtu ky projekt-udhëzim parashikon fazat e mirëmbajtjes periodike të fikseve të zjarrit/sistemeve stacionare të shuarjes së zjarrit sic janë: kontrolli fillestar, mirëmbajta periodike, rimbushja periodike si dhe mjetet për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-udhëzimi “Për kushtet teknike të importit-tregtimit , mirëmbajtjes, testimit të aparateve të fikjes së zjarrit”, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt-udhëzimi “Për kushtet teknike të importit-tregtimit, mirëmbajtjes, testimit të aparateve të fikjes së zjarrit” synon përafrimin me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt-udhëzimi “Për kushtet teknike të importit-tregtimit , mirëmbajtjes, testimit të aparateve të fikjes së zjarrit” disiplinon procedurat e klasifikimit dhe miratimit të standarteve për pajisjet e fikseve të zjarrit dhe ka për qëllim parandalimin e zjarrit të cilat i referohen standarteve/normave të miratuara sipas direktivave EN-3, EC lidhur me fikset e zjarrit.

Janë parashikuar kriteret që duhet të përmbushin personat fizikë apo juridikë për importin-tregtimin, testimin si dhe mjetet dhe pajisjet që duhet të kenë për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes periodike, rimbushjes periodike si dhe procesit të testimit të hidraulik të fikseve të zjarrit.

Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së gjatë kryerjes së funksioneve të saj në përmbushje të politikave dhe udhëzimeve të ministrit përgjegjës, synon arritjet e objektivave për zbatimin e politikave të përgjithshme dhe të programit të qeverisë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga zjarri dhe shpëtimin në shkallë vendi, si dhe i raporton periodikisht ministrit, mbi veprimtarinë e saj për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në legjislacionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e vendimit ngarkohet Ministria e Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt-udhezimi është bashkë hartuar nga Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Ministrinë e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projekt-udhezim nuk ka efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.

PROPOZUESI:

MINISTRI

BLENDAR ÇUÇI